



## **INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK**

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

**PROGRAMI KOMBËTAR I VAKSINIMIT**

## **PROCESI I VAKSINIMIT NDAJ COVID-19 DHE GRIPIT SEZONAL**

JAVA 49, 2025

### **Permbajtja:**

- 1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026 (java 49, 2025)**
- 2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 49, 2025)**

## 1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026

Vaksinimi ndaj gripit sezonal është një masë parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, komplikacionet dhe vdekjet e shkaktuara nga viruset respiratorë sidomos tek personat me semundje bashkëshoqeruese.

Programi Kombëtar i Vaksinimit, pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka shpërndarë në 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) **280,000 doza të vaksinës ndaj gripit sezonal**, përkatësisht:

- 40,000 doza në flakon një-dozësh
- 240,000 doza në flakon me 10 doza

Vaksinimi ndaj gripit sezonal për sezonin 2025–2026 nisi më **22 shtator 2025** në të gjithë vendin

### Llojet e vaksinave të përdorura

- Gjatë këtij sezoni, në Shqipëri po aplikohen **vaksinat 4-valente** me virion te copëzuar, te inaktivizuara, GC FLU të prodhuara nga GC Biopharma në Korenë e Jugut dhe të parakualifikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) **të cilat janë në flakone** prej 0.5ml dhe aplikohen në mënyre intramuskulare.

### Grupet prioritare:

Vaksinimi ndaj gripit rekomandohet për cdo person mbi 6 muaj por grupet prioritare në Shqipëri, me rrezik më të lartë janë si më poshtë:

- Punonjësit shëndetësorë (mjekë, infermierë, staf mbështetës)
- Personat dhe stafi i institucioneve të kujdesit afatgjatë
- Personat me sëmundje kronike (kardiovaskulare, pulmonare, diabet, astmë, sëmundje të mëlçisë ose veshkave si dhe semundje te gjakut etj.)
- Persona me kancer, limfoma etj,
- Persona obezë
- Personat me imunitet të kompromentuar si personat me HIV.
- Gra shtatzëna
- Persona mbi 65 vjeç

- Fëmijët mbi 6 muaj deri 12 vjec, sidomos ata me sëmundje bashkëshoqëruese.
- Mësuesët, edukatorët, policët dhe forcat e rendit.


### **Ecuria e vaksinimit:**

Aplikimi dhe regjistrimi në SIV i vaksinave ndaj gripit sezonal filloi më **22 shtator 2025**.

- Deri në **javën 49-të/2025 (22 Shtator – 7 Dhjetor)** janë kryer gjithsej **231 320 doza**, që përbëjnë **82.6 % të dozave të shpërndara**.
- NJVKSH-të me përdorim mbi 90% të vaksinave në të gjithë vendin janë **NJVKSH Skrapar (100 %)**, **NJVKSH Gramsh (99.5 %)**, **NJVKSH Fier (99.1 %)**, **NJVKSH Kuçovë (97.1 %)**, **NJVKSH Mallakastër (97.1 %)**, **NJVKSH Kukës (97 %)**, **NJVKSH Mirditë (95.4 %)**, **NJVKSH Devoll (95.2%)**, **NJVKSH Korçë (94.1 %)**, **NJVKSH Lezhë (93.4%)**, **NJVKSH Dibër (92.1 %)**, dhe **NJVKSH Has (91.2 %)**
- Grupmosha **mbi 80 vjeç** është me mbulesën më të lartë vaksinale (**30.7 %**).
- Personat mbi 60 vjeç kanë një mbulesë vaksinale (**23.8 %**) dhe kanë aplikuar në total **165 240** vaksina. NJVKSH-ja me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personat mbi 60 vjeç është **NJVKSH Tiranë** me **22 157** vaksina.
- Në grupet e riskut personat me **sëmundje kardiovaskulare** kanë mbulesën më të lartë vaksinale (**37.8 %**).
- Personat diabetikë kanë një mbulesë vaksinale (**28.5 %**) dhe në total janë aplikuar **28 490** vaksina. NJVKSH-të me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personat diabetikë janë **NJVKSH Tiranë** **3 800** vaksina.
- Mbulesa vaksinale e personelit shëndetësor është (**51.2 %**). Mjekë të vaksinuar janë 2 367, infermierë 9 523 dhe staf mbështetës janë vaksinuar 2 453. **NJVKSH-ja me numrin më të madh të aplikimeve të vaksinës tek personeli shëndetësor është NJVKSH Tiranë me 1 745 vaksina.**
- Mësuesit kanë përdorimin të mire të vaksinës, **2 089** vaksina të aplikuara.

*Vlen të theksohet që NJVKSH Tiranë ka mbulim më të mirë sepse ka numrin më të madh të popullsisë dhe personelit në çdo kategori.*


Ecuria e vaksinimit ndaj gripit sezonal sipas javëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm: Java 39 paraqet kulmin e vaksinimit me 74 450 doza, duke reflektuar fillimin e fushatës dhe interesin më të lartë nga grupet e riskut. Pas kësaj jave, nga java 40 deri në 49 vërehet një rënie graduale dhe e qëndrueshme javore të vaksinimeve, e cila përputhet me ritmin normal të fushatave sezonale: javët e para kanë fluks të lartë, ndërsa më pas volumi bie pasi pjesa më e madhe e personave që përfshihen në grupet e riskut janë vaksinuar. Në javën 49 vaksinimi vijon.



*Grafiku 1: Ecuria e vaksinimit sipas javëve*

**Përdorimi vaksinës ndaj Gripit në nivel qarku shprehur në hartë, java 49.** Harta paraqet përdorimin e vaksinës sipas 12 qarqeve, e cila varion ndjeshëm midis rajoneve. Përqindjet më të larta regjistrohen në Kukës (93.2 %), Berat (92.5 %), Korçë (91.7 %), Lezhë (89.7 %), Fier (86.6 %), Gjirokastrë (82.3%), Durrës (80%) dhe që tregojnë për një qasje të fortë ndaj vaksinimit dhe një angazhim të mirë të strukturave shëndetësore dhe komunitetit.

Qarqet me përdorim më të ulët janë Elbasani (72.4 %), Shkodra (78.3%), Vlora (78.5 %), Tirana (79.1%), Dibra (79.3%) dhe çka sugjeron nevojë për përf forcimin e fushatave informuese, mobilizimin e shërbimeve shëndetësore dhe adresimin e barrierave lokale (hezitimi dhe ndjekja aktive e grupeve të riskut).



Harta 1: Përdorimi i vaksinës ndaj Gripit në % sipas qarqeve


Shpërndarja e dozave të shpërndara dhe të aplikuara sipas 36 NJVKSH-ve paraqitet në tabelën e mëposhtme. Të dhënat tregojnë se shumica e NJVKSH-ve kanë një **përdorim të mirë** në aplikimin e vaksinës ndaj gripit sezonal.

|             | NJVKSH         | Sasia ne doza | Sasia e shperndare<br>(GC Flu 1/doze) | Sasia e aplikuar<br>me (GC Flu<br>1/doze) | % e aplikimit<br>(GC Flu<br>1/doze) | Sasia e<br>shperndare<br>(GC Flu<br>10/doze) | Sasia e<br>aplikuar<br>me (GC<br>Flu<br>10/doze) | % e<br>aplikimit<br>(GC Flu<br>10/doze) | TOTAL  | % e aplikimit ne total |
|-------------|----------------|---------------|---------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------------------|--------|------------------------|
| Shkodër     | Shkodër        | 14000         | 1000                                  | 733                                       | 73.3                                | 13000                                        | 9684                                             | 74.49                                   | 10417  | 74.41                  |
|             | Malësi e Madhe | 3500          | 500                                   | 346                                       | 69.2                                | 3000                                         | 2666                                             | 88.87                                   | 3012   | 86.06                  |
|             | Pukë           | 2500          | 500                                   | 306                                       | 61.2                                | 2000                                         | 1928                                             | 96.40                                   | 2234   | 89.36                  |
| Kukës       | Kukës          | 4000          | 500                                   | 485                                       | 97.0                                | 3500                                         | 3396                                             | 97.03                                   | 3881   | 97.03                  |
|             | Has            | 1500          | 500                                   | 436                                       | 87.2                                | 1000                                         | 932                                              | 93.20                                   | 1368   | 91.20                  |
|             | Tropojë        | 2000          | 500                                   | 484                                       | 96.8                                | 1500                                         | 1264                                             | 84.27                                   | 1748   | 87.40                  |
| Lezhë       | Lezhë          | 6000          | 500                                   | 466                                       | 93.2                                | 5500                                         | 5141                                             | 93.47                                   | 5607   | 93.45                  |
|             | Mirditë        | 2500          | 500                                   | 456                                       | 91.2                                | 2000                                         | 1930                                             | 96.50                                   | 2386   | 95.44                  |
|             | Kurbín         | 4500          | 500                                   | 500                                       | 100.0                               | 4000                                         | 3170                                             | 79.25                                   | 3670   | 81.56                  |
| Tiranë      | Tiranë         | 36000         | 6000                                  | 4475                                      | 74.6                                | 30000                                        | 24220                                            | 80.73                                   | 28695  | 79.71                  |
|             | Kavajë         | 7000          | 1000                                  | 724                                       | 72.4                                | 6000                                         | 4683                                             | 78.05                                   | 5407   | 77.24                  |
| Durrës      | Durrës         | 17000         | 3000                                  | 2094                                      | 69.8                                | 14000                                        | 11422                                            | 81.59                                   | 13516  | 79.51                  |
|             | Krujë          | 6000          | 1000                                  | 566                                       | 56.6                                | 5000                                         | 4318                                             | 86.36                                   | 4884   | 81.40                  |
| Dibër       | Dibër          | 6000          | 1000                                  | 792                                       | 79.2                                | 5000                                         | 4738                                             | 94.76                                   | 5530   | 92.17                  |
|             | Bulqizë        | 3500          | 500                                   | 376                                       | 75.2                                | 3000                                         | 1992                                             | 66.40                                   | 2368   | 67.66                  |
|             | Mat            | 3800          | 800                                   | 455                                       | 56.9                                | 3000                                         | 2196                                             | 73.20                                   | 2651   | 69.76                  |
| Fier        | Fier           | 27600         | 2600                                  | 2408                                      | 92.6                                | 25000                                        | 24941                                            | 99.76                                   | 27349  | 99.09                  |
|             | Mallakastër    | 2900          | 400                                   | 400                                       | 100.0                               | 2500                                         | 2415                                             | 96.60                                   | 2815   | 97.07                  |
|             | Lushnjë        | 22000         | 2000                                  | 1587                                      | 79.4                                | 20000                                        | 13724                                            | 68.62                                   | 15311  | 69.60                  |
| Vlorë       | Vlorë          | 18500         | 1500                                  | 1445                                      | 96.3                                | 17000                                        | 13697                                            | 80.57                                   | 15142  | 81.85                  |
|             | Delvinë        | 3450          | 450                                   | 413                                       | 91.8                                | 3000                                         | 1283                                             | 42.77                                   | 1696   | 49.16                  |
|             | Sarandë        | 4800          | 800                                   | 675                                       | 84.4                                | 4000                                         | 3570                                             | 89.25                                   | 4245   | 88.44                  |
| Gjirokastrë | Gjirokastrë    | 7500          | 1000                                  | 746                                       | 74.6                                | 6500                                         | 5159                                             | 79.37                                   | 5905   | 78.73                  |
|             | Përmet         | 3450          | 450                                   | 293                                       | 65.1                                | 3000                                         | 2715                                             | 90.50                                   | 3008   | 87.19                  |
|             | Tepelenë       | 3000          | 500                                   | 458                                       | 91.6                                | 2500                                         | 2116                                             | 84.64                                   | 2574   | 85.80                  |
| Korçë       | Korçë          | 11000         | 1000                                  | 924                                       | 92.4                                | 10000                                        | 9431                                             | 94.31                                   | 10355  | 94.14                  |
|             | Pogradec       | 6330          | 830                                   | 670                                       | 80.7                                | 5500                                         | 4790                                             | 87.09                                   | 5460   | 86.26                  |
|             | Devoll         | 2500          | 500                                   | 457                                       | 91.4                                | 2000                                         | 1923                                             | 96.15                                   | 2380   | 95.20                  |
|             | Kolonjë        | 1500          | 500                                   | 435                                       | 87.0                                | 1000                                         | 923                                              | 92.30                                   | 1358   | 90.53                  |
| Berat       | Berat          | 11000         | 1000                                  | 669                                       | 66.9                                | 10000                                        | 9065                                             | 90.65                                   | 9734   | 88.49                  |
|             | Kuçovë         | 3500          | 500                                   | 496                                       | 99.2                                | 3000                                         | 2903                                             | 96.77                                   | 3399   | 97.11                  |
|             | Skrapar        | 3500          | 500                                   | 500                                       | 100.0                               | 3000                                         | 3000                                             | 100.00                                  | 3500   | 100.00                 |
| Elbasan     | Elbasan        | 16000         | 4000                                  | 3510                                      | 87.8                                | 12000                                        | 7031                                             | 58.59                                   | 10541  | 65.88                  |
|             | Peqin          | 3000          | 500                                   | 338                                       | 67.6                                | 2500                                         | 1918                                             | 76.72                                   | 2256   | 75.20                  |
|             | Gramsh         | 3500          | 500                                   | 484                                       | 96.8                                | 3000                                         | 3000                                             | 100.00                                  | 3484   | 99.54                  |
|             | Librazhd       | 3500          | 500                                   | 306                                       | 61.2                                | 3000                                         | 2233                                             | 74.43                                   | 2539   | 72.54                  |
| Total       |                | 278330        | 38330                                 | 30908                                     |                                     | 240000                                       | 199517                                           |                                         | 230425 | 82.79                  |

Tabela 1: Sasia e dozave te shpërndara dhe përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, java 49


## Ecuria e procesit te vaksinimit sipas katër rajoneve të vendit, java 49, 2025

**DROSHKSH Tiranë:** përfshin NJVKSH Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Krujë, Tiranë dhe Kavajë. Në total janë aplikuar (79.5 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-ja me përdorimin më të lartë është NJVKSH Dibër (92.2 %). Përdorimi i vaksinës në përqindje për këtë rajon paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



*Grafiku 2: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Tiranë*


**DROSHKSH Shkodër:** përfshin NJVKSH Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Në total janë aplikuar (84.7 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Kukës (97 %), NJVKSH Mirditë (95.4 %) NJVKSH Lezhë (93.5 %), dhe NJVKSH Has (91.2 %).



*Grafiku 3: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Shkodër*


**DROSHKSH Elbasan:** përfshin NJVKSH Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Berat, Kuçovë, Skrapar, Elbasan, Peqin, Gramsh dhe Librazhd. Në total janë aplikuar (84.1 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me

përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Skrapar (100 %), NJVKSH Gramsh (99.5 %) ,NJVKSH Kuçovë (97.1 %) dhe NJVKSH Devoll (95.2 %).



Grafiku 4: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Elbasan


**DROSHKSH Vlorë:** përfshin NJVKSH Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë. Në total janë aplikuar (83.7 %) e dozave të marra për këtë rajon ku NJVKSH-të me përdorimin më të lartë të vaksinës janë NJVKSH Fier (99.1 %) dhe NJVKSH Mallakastër (97.1 %).



Grafiku 5: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Vlorë

### Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave


Grafiku më poshtë paraqet mbulesën vaksinale sipas grupmoshave. Grupmosha me mbulesën më të lartë vaksinale është mbi 80 vjeç (30.7 %).



Grafiku 6: Mbulesa vaksinale ndaj gripit sezonal sipas grupmoshave, java 49, 2025


### **Aplikimi i vaksinës sipas grupeve të riskut**

Grafiku paraqet administrimin e vaksinës tek personat me sëmundje kronike prioritare për tu vaksinuar ndaj gripit sezonal, ku ato me sëmundje kardiovaskulare kanë përdorimin më të lartë të saj.




Grafiku 7: Numri i vaksinave të aplikuara tek personat me sëmundje kronike, java 49, 2025


## Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut për të katër rajonet e vendit paraqitet në grafikët e mëposhtëm, java 49




Grafiku 8: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Shkodër



Grafiku 9: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Tiranë




Grafiku 10: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Elbasan



Grafiku 11: Administrimi i vaksinës sipas grupeve të riskut, DROSHKSH Vlorë

## Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut


Grafiku paraqet mbulesën vaksinale sipas grupeve të riskut dhe mbulesa vaksinale më e lartë është tek personat me sëmundje kardiovaskulare. Të dhënat e popullatës me sëmundje kronike janë marrë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (**FSDKSH**).



Grafiku 12: Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut, java 49, 2025


### Aplikimi i vaksinës tek personeli shëndetësor

Stafi mjekësor është ndër grupet më të ekspozuara ndaj gripit sezonal për shkak të kontaktit të vazhdueshëm me pacientët dhe ekspozimit të lartë ndaj infeksioneve respiratore. Në total në gjithë Shqipërinë në javën e 49-të/2025 janë vaksinuar 14,343 personel shëndetësor, me një mbulesë vaksinale **51.2 %**, ku infermierët përbëjnë grupin më të madh të vaksinuar me 9,523 vaksina.




Grafiku 13: Numri i vaksinave të aplikuara sipas personelit shëndetësor


## **Mbulesa vaksinale tek personeli shëndetësor në shërbimin parësor sipas katër rajoneve, java 49**




**Grafiku 14: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Shkodër**



**Grafiku 15: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Tiranë**




**Grafiku 16: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Vlorë**




**Grafiku 17: Mbulesa vaksinale në shërbimin parësor sipas personelit shëndetësor, DROSHKSH Elbasan**

Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit paraqitet në grafikët e mëposhtëm (të dhënat e numrit të stafit shëndetësor në këto spitale janë marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale):




**Grafiku 18: Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit**



**Grafiku 19: Mbulesa vaksinale në spitalet e vendit sipas personelit shëndetësor**

Grupet në risk prioritare për tu vaksinuar lidhur me profesionet janë shprehur në grafikun e mëposhtëm dhe numri më i madh i vaksinave është aplikuar tek mësuesit.



*Grafiku 20: Numri i aplikimit të vaksinave sipas profesioneve*

## 1. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 49, 2025)

Në mbledhjen e datës 22 gusht 2024, Komiteti Shqiptar i Ekspertëve të Vaksinimit (NITAG) rekomandoi:

1. Vaksinimi ndaj COVID-19 duhet të vazhdojë.
2. Çdo vit duhet të aplikohet vakcina ndaj COVID-19 për grupet më prioritare dhe në rrezik.
3. Vakcina COVID-19 duhet të administrohet në të njëjtën kohë me vaksinën kundër gripit sezonal, kur është e mundur, për të shmangur që qytetarët të paraqiten dy herë në qendrat shëndetësore.
4. Të vaksinohen me një dozë të vaksinës monovalente, pavarësisht nga statusi i mëparshëm i vaksinimit, personat në grupet e mëposhtme:

- Punonjësit shëndetësorë dhe ata që punojnë në institucione të kujdesit afatgjatë.
- Personat që jetojnë në institucione të kujdesit afatgjatë (mbi 12 vjeç).
- Të gjithë personat mbi 60 vjeç.
- Personat mbi 12 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese, përfshirë:
  - Sëmundje kardiovaskulare.
  - Diabet.
  - Sëmundje obstruktive të mushkërive.
  - Sëmundje kronike të veshkave dhe mëlçisë.
  - Lloje të ndryshme kanceri.
  - Gjendje që shkaktojnë frenim të imunitetit.
  - Obezitet.
- Gratë shtatzëna.

### **Vaksina COMIRNATY™ e Disponueshme në Shqipëri:**

Aktualisht në Shqipëri është e disponueshme vakcina **COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]**

#### **COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]**


- **Përmbajtje aktive:** *bretovameran* (mRNA për nënvariantin Omicron JN.1)
- **Përdorimi:** 30 mikrogramë për adoleshentë dhe të rritur  $\geq 12$  vjeç
- **Data e skadencës së dozave të ardhura:** 31 mars 2026
- **Sasia e ardhur më 17 prill 2025:** 5,760 doza

### **Dokumentimi i Vaksinimit**

Çdo vaksinë e administruar regjistrohet **në kohë reale në Sistemin e Informimit të Vaksinimit (SIV)** dhe është e disponueshme për qytetarët në **portalin e-Albania**, te seksioni **“Kartela ime e Vaksinimit”**.


Kartela ofrohet në **shqip dhe anglisht** dhe është e vlefshme për përdorim personal apo zyrtar.

Nga fillimi i përdorimit në javën e 43-të të vitit 2024 deri në javën e 49-të të vitit 2025, në Shqipëri janë administruar gjithsej **1,647 doza**.



*Grafiku 1. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 të aplikuara sipas javeve, (java 43, 2024-java 49, 2025)*


Grafiku paraqet numrin e vaksinave COVID-19 të aplikuara sipas javëve, për periudhën 2024–2025. Megjithëse rekomandohet aplikimi i vaksinës kundër COVID-19, vihet re një ulje e kërkesës nga qytetarët dhe, si pasojë, edhe e numrit të vaksinave të administruara.



*Grafiku 2. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 të aplikuara sipas NJVKSH-ve (java 43, 2024-java 49, 2025)*

Sic shihet në grafik **Tirana** ka numrin më të lartë të vaksinave (510), ndjekur nga **Fieri** (191) dhe **Vlora** (142).


Stafi mjekësor përbën një nga grupet me risk të lartë për ekspozim ndaj infeksionit me COVID-19, për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me pacientët dhe mjediset shëndetësore. Vaksinimi i këtij grupi është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre personal, por edhe për të garantuar sigurinë e pacientëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë, të dhënat tregojnë se përdorimi i vaksinës në këtë kategori mbetet i ulët. Ne total janë aplikuar **79 doza** deri në javën e 49, 2025.



*Grafiku 3: Numri i stafit mjeksor të vaksinuar ndaj COVID-19, (java 43, 2024-java 49, 2025)*

**Infermierët** kanë numrin më të madh të vaksinimeve (46), ndjekur nga **mjekët** me (24). **Stafi mbështetës** ka marrë **9 doza**. **Totali i përgjithshëm është 79**, duke reflektuar numrin e përgjithshëm të vaksinimeve në këtë kategori profesionale.


Grupet në rrezik për komplikacione të rënda nga COVID-19 përfshijnë të moshuarit, personat me sëmundje kronike (si diabet, hipertension, sëmundje kardiovaskulare, respiratore, renale dhe hepatike), individët me imunitet të kompromentuar, gratë shtatzëna, si dhe punonjësit shëndetësorë. Vaksinimi i këtyre grupeve është një masë thelbësore parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, format e rënda të sëmundjes dhe rrezikun e vdekshmërisë. Për më tepër, mbrojtja e këtyre kategorive ka ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e kapaciteteve të sistemit shëndetësor dhe në sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve të tjera mjekësore. Rekomandimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare theksojnë rëndësinë e vaksinimit periodik për këto grupe, duke pasur parasysh se imuniteti i fituar nga vaksina apo infeksioni i mëparshëm zbehet me kalimin e kohës.



*Grafiku 1: Numri i personave të vaksinuar ndaj COVID-19 sipas grupeve të riskut, (java 43, 2024-java 49, 2025)*

## Vaksinimi ndaj COVID-19 sipas grupmoshave

Vaksinimi kundër COVID-19 mbetet një ndër masat kryesore për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes dhe uljen e numrit të shtrimeve në spitale. Efektiviteti dhe rëndësia e vaksinimit ndryshon sipas grupmoshave, duke reflektuar nivelin e rrezikut që secila kategori paraqet. Grupmosha **25–39 vjeç** ka numrin më të lartë të vaksinimeve (463 raste). Pas saj renditen grupmoshat **50–59 vjeç (317 raste)** dhe **60–69 vjeç (306 raste)**. Grupmoshat më të reja (12–17 vjeç) dhe më të moshuarit mbi 80 vjeç kanë numrat më të ulët të vaksinimit.



*Grafiku 2: Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas grup-moshave, (java 43, 2024-java 49, 2025)*

INSTITUTI I  
SHËNDETIT PUBLIK